



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 09/08

Prishtinë, më 08.05.2008, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Safete Hadergjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxherri, Müfera Şinik, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Behxhet Pacolli, Myrvete Pantina.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitorues nga ZKM, OSCE, KDI, NDI, ZPK.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Jo kontestimore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Përmbaruese me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion,**

- me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
 7. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
 8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;
 9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari hapi mbledhjen duke ftuar të pranishmit të deklarohen lidhur me propozimin për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar i datës 23.04.2008, u miratua vërejtjen e z. Armend Zemaj lidhur me një gabim teknik në diskutimin e tij..

Në vazhdim Kryetari hapi për shqyrtim pikën e tretë të rendit të ditës

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Jo kontestimore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente

Pasi që nuk kishte anëtarë të paraqitur për diskutim, kryetari konstatoi se komisioni përkrahë Projektligjin për Procedurën Jo kontestimore me raportin e komisionit funksional dhe ftoi anëtarët të deklarohen përmes votimin lidhur me projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

Rekomandime

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Procedurën Jokontestimore dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Më pas, kryetari hapi për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Përmbarese me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente

Haki Shatri kërkoi vëmendjen e komisionit që gjatë shqyrtimit të dytë të këtij projektligji me

amendamente në seancë plenare, të kërkohet nga kryetari i komisionit funksional sqarim lidhur me amendamentin 7 të këtij komisioni, pasi që është i pakuptueshëm, nuk është i përfunduar dhe nuk dihet qëllimi i tij.

Meqë nuk pati të tjerë anëtarë të paraqitur për diskutim, kryetari i komisionit i ftoi ata të deklarohen përmes votimit lidhur me projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

Rekomandime

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Procedurën Përmbarese dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. **Sugjerim**
Komisioni për Buxhet dhe Financa i sugjeron Kuvendit që me rastin e shqyrtimit të amendamenteve të propozuara, të kërkojë sqarim nga ana e kryetarit të komisionit përgjegjës referues lidhur me Amendamentin 7 në nenin 12.5 të projektligjit, sepse i njëjti i pakuptueshëm.
- IV. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Në vazhdim, kryetari hapi për diskutim pikën e pestë të trendit të ditës

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Safete Hadergjonaj, gjithashtu edhe anëtare e komisionit funksional për këtë projektligj, deklaroi se raporti i komisionit funksional i cili i është dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa për shqyrtim, nuk është raporti i cili është miratuar në komisionin funksional dhe kërkoi nga komisioni që të njëjtin të mos e shqyrtojë. Kjo sipas saj, për arsye se disa nga amendamentet të cilat janë bërë në komision funksional, nuk shihet se janë të përfshirë në raport, përderisa disa të tjerë që figurojnë në raport, nuk janë miratuar në komision. Kjo mund të vërtetohet edhe përmes procesverbalit nga mbledhja e komisionit funksional kur është miratuar raporti, se procesverbali është në kontradiktë me raportin. Znj. Hadergjonaj, theksoi se kishte biseduar me kryetaren e komisionit funksional lidhur me mundësinë e tërheqjes së raportit nga procedura e mëtejme e shqyrtimit, dhe tani nuk ishte në dijeni se pse nuk është bërë një gjë tillë nga komisioni funksional.

Edhe **Haki Shatri**, gjithashtu anëtar edhe i komisionit funksional për këtë projektligj, shpreh se nuk ishte i sigurt nëse disa amendamente nuk janë ato të cilat janë miratuar në mbledhje të komisionit funksional, mirëpo nëse ekziston një gjë e tillë, për të kjo është një situatë serioze.

Edhe anëtarët tjerë të komisionit u shprehën mjaft të shqetësuar dhe të befusuar për mundësinë e krijimit të një situatë të tillë, që një raport mund të nënshkruhet dhe të dalë nga komisioni i cili nuk përmban qëndrimet dhe vendimet që janë marrë në komision, por ndryshohet dhe në këtë mënyrë bëhet shkelje e rënde e procedurave të punës.

Ata u shprehën të interesuar që të vërtetohet saktësia e raportit të komisionit funksional, të kërkohet dhe të dihet përgjegjësia për një veprim të tillë dhe një situatë e tillë të mos tolerohet të përsëritet më.

Kryetari propozoi që të hiqet nga shqyrtimi raporti i komisionit funksional dhe të presin tu dorëzohet raporti final i cili është miratuar në komision, e pastaj këtë raport ta shqyrtojnë se bashku me projektligjin.

Ky propozim u përkrah nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe komisioni mori këtë

Qëndrim

Hiqet nga shqyrtimi Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional, për ta shqyrtuar pas vërtetimit të saktësisë së raportit të komisionit funksional dhe dorëzimit të tij për shqyrtim.

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e gjashtë të rendit të ditës

6. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Armend Zemaj, gjithashtu edhe anëtar i komisionit funksional për këtë projektligj, njoftoi komisionin për punën e bërë në atë komision. Ai ftoi deputetët të përkrahin këtë projektligj sepse është i një rëndësie mjaft të madhe për një kategori të ndjeshme të popullsisë dhe që përmes tij është paraparë rregullimi ligjor dhe sigurimi i përkrahjes materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme dhe familjet e tyre.

Meqë nuk kishte anëtarë të tjerë të lajmëruar për diskutim, kryetari ftoi ata të deklarohen përmes votimit për projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

Rekomandime

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III.** Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Në vazhdim kryetari hapi për shqyrtim pikën e shtatë të rendit të ditës

7. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Për këtë projektligj pati vërejte nga anëtarët e komisionit, lidhur me atë se a janë specifikuar dhe llogaritur mirë implikimet buxhetore që parasheh ky projektligj. Gjithashtu kishte vërejtje edhe me gjuhën juridike të përdorur gjatë hartimit të amendamenteve, me ç'rast amendamentet sipas anëtarëve të komisionit, nuk janë mirë të formuluar.

Armend Zemaj, në cilësi edhe të anëtarit të komisionit funksional për këtë projektligj, sqaroi para anëtarëve tjerë amendamentet me cilat komisioni ka menduar ta plotësojë dhe përmirësojë projektligjin. Ai theksoi se kjo skemë e tillë sociale që parashihet me projektligj veç është në aplikim, por që tani vetëm duhet të rregullohet dhe sigurohet me ligj që për personat me aftësi të kufizuara, në fazat e riaftësimit të tyre, një shumë e të ardhurave duhet të paguhet nga punëdhënësi, kurse pjesa tjetër nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mënyrë që këtyre personave tu mundësohet marrja e të ardhurave në formë të pagës së plotë.

Shkumbin Demaliaj theksoi se komisioni nuk ka pasur objektiva profesionale gjatë shqyrtimit të projektligjit. Kjo sipas tij vërehet në amendamentet ku ne vend të agjencionit, i ka kaluar kompetencat te ministria. Po ashtu sipas z. Demaliaj mungesa e fondit të sigurimeve shëndetësore si dhe fondit për nxitjen e punësimit krijon vështirësi në mundësinë e aplikimit të këtij projektligji. Por për shkak se ky projektligj tenton të rregullojë rehabilitimin profesional të një kategorie mjaft të ndjeshme dhe të veçantë, siç është kjo kategori e personave me aftësi të kufizuara, ai u shpreh i gatshëm për të përkrahur këtë projektligj në procedim të mëtutjeshëm.

Besa Gaxherri kishte vërejtje lidhur me amendamentet 27 dhe 28 të komisionit funksional, duke theksuar se do duhej që në projektligj ose amendamente të përcaktoheshin me qartë implikimet buxhetore që do të krijojnë themelimi i qendrës për aftësimin dhe riaftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara, për ta bërë projektligjin sa më të aplikueshëm.

Hajdin Abazi kishte vërejtje në projektligj dhe amendamente sa i përket formulimit gjuhësor të përdorur gjatë hartimit. Sipas tij, propozuesi i projektligjit e po ashtu edhe komisioni si propozues i amendamenteve duhet të kenë kujdes që gjatë hartimit të mos krijojnë huti dhe paqartësi lidhur me atë se çka ka dashur propozuesi të paraqesë, sepse në këtë mënyrë do të bëhet projektligji i pazbatueshëm.

Haki Shatri theksoi se gjuha e përshtatshme juridike është dashur të përdoret gjatë hartimit të projektligjit, por gjithashtu edhe me rastin e hartimit të amendamenteve. Ai kishte vërejtje në amendamentet 31 lidhur me termin 'nën kod buxhetor' të komisionit funksional, i cili sipas z. Shatri nuk mund të përcaktohet në ligj, por kjo rregullohet me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe sipas procedurave të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financa, dhe amendamentin 32 lidhur me termin 'të ardhurat' ku sipas z. Shatri do duhej të përdoret termi 'burimet financiare'.

Meqë kishte vërejtje të shumta nga anëtarët e komisionit dhe nevojë për sqarime të mëtutjeshme lidhur me projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional, Kryetari propozoi që rekomandimet për këtë projektligj ti japë komisioni pas marrjes së sqarimeve dhe informatave shtesë nga kryetari i komisionit funksional dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në një takim të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Ky propozim u përkrah nga anëtarët tjerë të komisioni mori këtë

Qëndrim

Në mbledhjen e ardhshme të Komisionit për Buxhet dhe Financa ftohen përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kryetari i komisionit funksional për të shqyrtuar projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të

kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kryetari, në vazhdim, hapi për shqyrtim pikën e tetë të rendit të ditës

8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente

Safete Hadergjonaj konsideroi të nevojshme thirrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së punëve të brendshme në mbledhje të komisionit gjatë shqyrtimit të këtij projektligji. Por meqë kjo nuk është bërë, sipas saj mbetet mjaft e pa sqaruar çështja e implikimeve buxhetore që parasheh zbatimin e këtij projektligji. Sipas z. Hadergjonaj, në deklaratën financiare të projektligjit është paraqitur kosto shtesë dhe mjetet buxhetore nuk janë paraparë në buxhetin e ministrisë e as në Kornizën afatmesme. Ajo ftoi anëtarët tjerë të komisionit që të jenë të kujdesshëm me këtë rast, të kërkohen sqarime shtesë nga propozuesi i projektligjit lidhur me koston financiare të tij.

Besa Gaxherri kishte vërejtje lidhur me shumat e gjobave të parapara me projektligj e po ashtu edhe ato të cilat janë propozuar përmes amendamenteve nga ana e komisionit funksional. Sipas saj, nuk do duhej të lihej një hapësirë aq e madhe ndërmjet shumës më të ultë dhe asaj me të lartë të gjobës së paraparë. Kjo krijon mundësinë që personat e autorizuar të cilët shqiptojnë gjobat, të korruptohen me qëllim të shqiptimit të gjobës më të ultë krahas mundësisë së shqiptimit të gjobës më të lartë për të njëjtën shkelje të ligjit.

Kryetari theksoi se praktika e përcaktimit të shumave më të ulëta dhe më të larta të gjobave në ligje bëhet për arsye se shkeljet e ligjit nuk bëhen në shkallë të njëjtë nga të gjithë personat. Për këtë qëllim, është gjykata e cila vlerëson se çfarë shkelje e ligjit është bërë dhe sipas këtij vlerësimi edhe shqiptohet gjoba e paraparë me ligj, me mundësi që varësisht nga shkalla e shkeljes së bërë, shqiptohet gjoba ndërmjet kufijve më të ultë dhe më të lartë. Kjo është një rregull dhe praktikë juridike dhe e tillë duhet të mbetet.

Gjithashtu kryetari u shpreh kundër paragjyqimeve të bëra ndaj vlerësimit dhe gjykimit nga gjykata. Sipas tij, gjyqtarët janë autonom në dhënien e gjyqimeve dhe mbetet në ndërgjegjen e tyre, vlerësimi i drejtë ose jo i palëve në gjykim.

Pas diskutimeve të bëra, kryetari ftoi anëtarët e komisionit të deklarohen përmes votimit për projektligjin me amendamente.

Pas votimit të bërë, me shumicë votash, Komisioni nxori këto

Rekomandime

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit përmbajnë implikime buxhetore, për të cilat propozuesi (Ministria e Punëve të Brendshme) ka planifikuar përballimin e tyre.
- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III.** Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Në vazhdim kryetari hapi për diskutim pikën e nëntë të rendit të ditës

9. Të ndryshme

Kryetari dha vërejtjet e tij lidhur me punën e dy grupeve punuese të komisionit, të cilat ende nuk kanë filluar me punën e tyre. Ai kërkoi nga grupi punues i caktuar me vendim për të bërë propozimet për kompensimin e deputetëve, që në afatin sa më të shkurtë kohor të filloj punën dhe të paraqes raportin me rekomandime pranë Komisionit, sepse nuk ka mbetur edhe shume kohë për tu bërë përgatitjet e duhura për propozimet të cilat do të merren ne shqyrtim me rastin e rishikimit të buxhetit në muajin qershor.

Haki Shatri, kryesues i grupi punues për të bërë propozimet për kompensimin e deputetëve, ftoi anëtarët e këtij grupi që të mbajnë mbledhjen e tyre pas mbledhjes së ardhshme të Komisionit. Ai deklaroi se në bashkëpunim me sekretarinë e Kuvendit do të marrë informacionet e nevojshme të cilat do t'ua paraqesë grupit punues, në bazë të të cilave do përgatisin rekomandimet e tyre.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit u caktua për të mërkurën më 14 maj 2008, prej orës 11:00.

Kryetari konstatoi se mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14:40.

Procesverbalin e përgatiti

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani Koci